



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALIQ

SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Maliq, më 25.03.2024

Projekt-Vendim - NR. 5

**“MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËFINANCIMIT TË PROJEKTIT TË PËRBASHKËT TË BASHKISË MALIQ, DORCAS ALBANIA DHE MISIONI EMANUEL, MË QËLLIM “NGRITJEN E QENDRËS DITORE PER FËMIJË”**

Në mbështetje të ligjit nr . 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, dhe vkm-së nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, Bashkia Maliq në bashkëpunim me Dorcas Albania, Misioni Emanuel do të mundësojë ngritjen e një qendre ditore për fëmijët në qytetin e Maliqit për këtë arsye kërkohet nga Këshilli i Bashkisë Maliq:

1. Mbi miratimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit të projektit të përbashkët të Bashkisë Maliq Dorcas Albania dhe Misioni Emanuel, më qëllim “ Ngritjen e Qendrës ditore per fëmijë ”
2. Të miratojë përdorimin e fondit prej 360 000 lekë në zbatim të buxhetit të projektit “Ngritjen e Qendrës ditore per fëmijë” te detajuar si më poshtë :

	Gr.	kap	Kod. Prog.	Llog.eko	Objekti	Vlera në lekë
Pakësim	00	05	01110	606	Fondi Social	360 000
Shtesë	00	05	01110	602	Qera Ambjenti	360 000

3. Ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi mbas miratimit nga ana e institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë .
5. Relacioni bashkëngjitur projekt-vendimit

Përgj i Sekt. Sh.të kujdesit Shoqëror  
Miratoi:Dr.Finances dhe Buxhetit


(Emër Mbiemër)  
E.Petriti  
A.Muka

Nënskrimi

Data  
Dt 25.03.2024  
Dt 25.03.2024

**KRYETARLI BASHKISË**

**Gëzim Topçiu**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALIQ  
SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Maliq, më 25.03.2024

RELACION

“MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËFINANCIMIT TË PROJEKTIT TË PËRBASHKËT TË BASHKISË MALIQ, DORCAS ALBANIA DHE MISIONI EMANUEL, MË QËLLIM “NGRITJEN E QENDRËS DITORE PER FËMIJË”

Në mbështetje të ligjit nr . 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, dhe vkm-së nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, Bashkia Maliq në bashkëpunim me Dorcas Albania dhe Misioni Emanuel do të zhvillojë një sërë aktivitetesh në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për projektin e përbashkët “Ngritjen e Qendrës Ditore per Fëmijë”

Qëllimi kryesor i projektit është zgjerimi i shërbimeve ditore për fëmijët në territorin e Bashkisë Maliq , me synim përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, drejt një jetese dinjitoze dhe pa pengesa për ta, fuqizimi i familjeve të tyre për krijimin e një komuniteti gjithëpërfshirës ku përfituesit e drejtpërdrejtë të projektit do të jenë fëmijët e Qytetit të Maliqit dhe komuniteti i gjerë. Dorcas Albania dhe Misioni Emanuel angazhohen në sigurimin e gjithë bazës materiale për zhvillimin e aktivitetit duke përfshirë edhe pagesën e stafit përbërës së qendrës për një periudhë 3 vjecare me të drejtë rinovimi. Nga ana e Bashkisë Maliq kërkohet pagesa e qerasë së ambjentit dhe faturat e energjisë elektrike dhe ujit.

Aktivitetet kryesore që do të mbështeten nga ky projekt konstatojnë në :

- Ngritja e një qendre të re për ofrimin e shërbimit ditor për fëmijët e familjeve në nevojë
- Ofrimi i një vakti të shëndetshëm, asistencë në procesin e të mësuarit etj.
- Aktivitete me qëllim ndërgjegjesim dhe informim mbi tematika të ndryshme si higjiena, dhuna, të drejtat e fëmijëve, prindërimi pozitiv etj
- Bashkëpunimin me OJF dhe shkollen 9-vjecare “Agimi” Maliq për vlerësimin e nevojave të fëmijëve me qëllim ndërhyrjen edhe ne mjedisin familjar për të përmirësuar kushtet familjare për mirëritjen e tyre.

Konceptoi:  
Pranoi; Përgj i Sekt. Sh.të kujdesit  
Shoqëror

A.Lenja  
E.Petriti

Dt 25.03.2024  
Dt 25.03.2024

**KRYETARI I BASHKISË**  
**Gëzim Topçiu**

